

SHOQERIA "DAJKO-KOCI" SH.P.K

S A R A N D E

V E N D I M Nr.3

I ASAMBLESE SE JASHTEZAKONSHME TE SHOQERISE "DAJKO-KOCI"SH.P.K.

Asambleja e jashtezakonshme e shoqerise "Dajko-Koci"Sh.p.k. e mbledhur sot me daten 24.11.2004 pasi mori ne shqyrtim rendin e dites te caktuar nga administratori i saj per miratimin e raportit te ekspertit kontabel per zmadhimin e kapitalit nga fitimet e realizuara dhe rezervat e krijuara deri me 31.12.2003,

K O N S T A T O I S E :

Znj.Anthulla Cako me cilisine e administratores ne shoqerine "Dajko-Koci"Sh.p.k. ka paraqitur asamblese se ortakeve kerkesen per miratimin e raportit te ekspertit kontabel per zmadhimin e kapitalit nga fitimet e realizuara dhe rezervat e krijuara deri me 31.12.2003 sipas dokumentacionit qe disponon shoqeria pa ndryshuar perqindjet e pjesemarrjes se ortakeve ne kapitalin e shoqerise.

Ne diskutimet e bera nga ortaket e shoqerise u shprehen per miratimin e raportit te ekspertit kontabel per zmadhimin e kapitalit nga fitimet e realizuara dhe rezervat e krijuara nga shoqeria deri me 31.12.2003.

Per sa me larte ne mbeshtetje te Statutit te Shoqerise dhe Ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" asambleja e ortakeve te shoqerise,

V E N D O S I

1.Miratimin e raportit te ekspertit per zmadhim te kapitalit prej 6.655.000leke, pra nga 100.000 leke qe ishte te behet prej 6.755.000 leke.

2.Gjithe dokumentacioni I pregatitur per zmadhimin e kapitalit themaltar nga fitimet e realizuara dhe rezervate e krijuara deri me 31.12.2003 te Shoqerise "DAJKO-KOCI."SH.P.K te depozitohet ne regjistrin tregtar sipas kerkesave te Ligjit "Mbi Shoqerite Tregtare " dhe statutit te shoqerise.

Vendimi u muar nga ortaket.

ASAMBLEJA E JASHTEZAKONSHME E SHOQERISE "DAJKO-KOCI."SH.P.K.



DAJKO - KOCI
SARANDE - ALBANIA

SHOQERIA "DAJKO-KOCI."SH.P.K.

S A R A N D E

PROCES - V E R B A L

I mbjatur sot me daten 24.11.2004 nga sekretari Sotir Koci, lidhur me zhvillimin e mbledhjes se jashtezakonshme te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise "DAJKO-KOCI"SH.P.K.

Mbledhja e Asamblese se Jashtezakonshme e Shoqerise mbahet me daten 24.11.2004,prane zyrave te shoqerise,sipas njoftimit te bere nga administratore e Shoqerise,me rend dite per miratimin e raportit te ekspertit per zmadhimin e kapitalit themeltar nga fitimet e realizuara dhe rezervat e krijuara deri me 31.12.2003 nga shoqeria "Dajko-Koci"Sh.p.k.

Ne mbledhje moren pjese ortaket Z.Spiro Dajko, Z.Sotir Koci dhe Znj.Anthulla Cako. Mbledhja eshte thirrur nga administratorja Anthulla Cako.

Ne mbledhje u shqyrtua raporti i paraqitur nga eksperti si dhe dokumentacioni bashkangjitur ketij raporti per zmadhimin e kapitalit themeltar pa ndryshuar kuotat e pjesemarrjes ne kapital te ortakeve dhe per rritjen e numrit te pjeseve te kapitalit ne proporcion me rritjen e kapitalin themeltar te shoqerise.

Ortaket u shprehen qe zmadhimi i kapitalit themeltar do te jete gjithsej ne shumen prej 6.655.000 leke t cili do te jete nga fitimet e realizuara nga shoqeria deri me 31.12.2003 ne shumen prej 6.315.000 leke si dhe nga krijimi i rezervave deri me 31.12.2003 ne shumen prej 340.000 leke, si dhe per rritjen e numrit te pjeseve te kapitalit themeltar sipas raportit te ekspertit gjithsej 6.655 pjese.

Ne mbledhje u vendos qe shoqeria "Dajko -Koci"Sh.p.k..te rrise kapitalin themeltar nga 100.000 leke ne 6.755.000 leke, ku zoterohet nga ortaket si:

- 1.Z.Spiro Dajko zoteron 33 % te kapitalit themeltar, ose 2.229.150 leke,
- 2.Z.Sotir Koci zoteron 33 % te kapitalit themeltar, ose 2.229.150 leke,
- 3.Znj.Anthulla Cako zoteron 34 % te kapitalit themeltar, ose 2.296.700 leke.

Vendimi qe mori Asambleja e jashtezakonshme e Ortakeve te Shoqerise u votua nga ortaket.

Sarande,me 24.11.2004

SEKRETARI
Sotir KOCI

DREJTUESI
Anthulla CAKO

SH.P.K.
DAJKO - KOCI
SARANDE - ALBANI

RAPORT
I
EKSPERTIT KONTABEL

Une e quajtura Leze Abazi, eksperte kontabel e autorizuar e ngarkuar me detyren e përgatitjes së raportit për zmadhimin e kapitalit themeltar të shoqërisë "Dajko-Koci." Sh.p.k. Sarandë nga vlera e fitimeve të realizuara dhe rezervat e krijuara nga shoqëria deri më 31.12.2003, paraqet raportin tim si vijon:

Nga data 28.10.2004 deri më datën 24.11.2004 kam ndjekur punën e realizuar nga drejtimi i shoqërisë si dhe procedurat e ndjekura nga shoqëria "Dajko-Koci." Sh.p.k. Sarandë lidhur me përcaktimin e vlerës së kontributeve të ortakut nga fitimet e rezervat deri më 31.12.2003, që do të shtohen në formën e zmadhimit të kapitalit themeltar të shoqërisë "Dajko-Koci" Sh.p.k. Sarandë

Nga ana ime u kontrolluan të gjitha dokumentat e përgatitura nga shoqëria për përcaktimin e vlerës së kontributeve nga fitimet e realizuara dhe rezervat e krijuara deri më 31.12.2003 që do të shtohen kapitalit të shoqërisë "Dajko-Koci" Sh.p.k. Sarandë. Nga verifikimet e bëra konstatova se drejtimi i shoqërisë ka respektuar rregullat e përcaktuara në statutin e shoqërisë,

kerkesat e Ligjit nr. 7661 datë 19.01.93 "Për Kontabilitetin" dhe Planin Kontabel I Përgjithshëm i Shqipërisë, si dhe kerkesat e Ligjit nr. 7638 i datës 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare»

Regjistrimet kontabile në llogaritë perkatese të fitimeve dhe të rezervave të shoqërisë nga ortakët për përcaktimin e shumës totale të zmadhimit të kapitalit janë kryer në mënyrë të plotë dhe të rregullt.

Bilanci i shoqërisë që pasqyron vlerën e fitimeve të realizuara dhe rezervat e krijuara të shoqërisë deri më 31.12.2003 që do të shtohet kapitalit themeltar të shoqërisë "Dajko-Koci" Sh.p.k. Sarandë në formën e zmadhimit të kapitalit, si dhe dokumentacioni justifikues për egzistencën e kunderspartisë reale të regjistruar në librat kontabile dhe aktivin e shoqërisë japin një pamje besnike të pasurisë dhe të gjendjes financiare aktuale të shoqërisë.

Kapitali themeltar i shoqërisë "Dajko-Koci" Sh.p.k. Sarandë që do të zmadhohet (shtohet) është **prej 6.655.000 leke.**

Kapitali themeltar i shoqërisë "Dajko-Koci" Sh.p.k. behet prej 6.755.000 (gjashtëmiljoneshtëqintepesëdhjetepesemije) leke, (ishte 100.000 leke behet 6.755.000 leke), ku zotërohet nga ortakët:

1. Z. Spiro Dajko zotëron 33 % të kapitalit themeltar, ose 2.229.150 leke,
2. Z. Sotir Koci zotëron 33 % të kapitalit themeltar, ose 2.229.150 leke,
3. Znj. Anthulla Cako zotëron 34 % të kapitalit themeltar, ose 2.296.700 leke.

Sarandë, më 24 Nëntor 2004

EKSPERTE KONTABEL E AUTORIZUAR
Leze ABAZI

Eksperte Kontabeli e Autorizuar
LEZE ABAZI

RAPORT
PER VLERESIMIN E ZMADHIMIT TE KAPITALIT TE SHOQERISE
“DAJKO-KOCI”SH.P.K.



Ne zbatim te Vendimit N.2, date 26.10.2004 te Asamblese se ortakeve te shoqerise “Dajko-Koci”Sh.p.k. “Per miratimin e ekspertit kontabel znj.Leze Abazi per hartimin e raportit per zmadhimin e kapitalit te shoqerise nga fitimet e realizuara dhe rezervat e krijuara deri me 31.12.2003, kam pranuar misionin per hartimin e raportit te zmadhimit te kapitalit te shoqerise se mësiperme “Dajko-Koci”Sh.p.k.Sarande.

Verifikimi dhe vertetimi i dokumentacionit te fitimeve te realizuara dhe te rezervave te krijuara nga shoqeria deri me 31.12.2003 dhe te vleresimit te aktiveve te qendrueshme e qarkulluese reale ne aktivin e shoqerise te krijuara nga keto fitime e rezerva te shoqerise “Dajko-Koci”Sh.p.k. realizohet nga znj.Leze Abazi.

Per realizimin e vleresimit te ketij kapitali (zmadhim kapitali) jam mbështetur ne aktet ligjore e nenligjore perkatese, në dokumentacionet qe dispononte drejtimi i shoqerise, si dhe në dokumentacionet e tjera dhe pikerisht:

1-Ne Bilancet Kontabel te viteve ku jane percaktuar dhe treguesit ekonomiko-financiare.

2-Ne Vendimin Nr.2 date 26.10.2004 te Asamblese se ortakeve te Shoqerise “Dajko-Koci”sh.p.k per miratimin e ekspertit per hartimin e raportit per zmadhimin e kapitalit nga fitimet e realizuara dhe rezervat e krijuara deri me 31.12.2003 nga shoqeria.

3-Ne proces-verbalin e mbledhjes se asamblese se jashtezakonshme te Shoqerise “Dajko Koci”Sh.p.k.

4-Ne Vendimin Nr.12025/1 date 19.11.2004 I Gjykates se rrethit Tirane, per miratimin e ekspertes Leze Abazi per hartimin e raportit te zmadhimit te kapitalit nga fitimet e realizuara dhe rezervat krijuara deri me 31.12.2003.

5-Ligji nr 7661 datë 19.01.93 “Per Kontabilitetin” dhe Plani Kontabel I Pergjithshem i Shqiperise.

6-Ligji nr. 7638 i dates 19.11.1992 “Per shoqeritë tregtare» .



7-Statuti I shoqerise "Dajko-Koci"Sh.p.k.

8-Ligji Nr.8438, date 28.12.199 "Per Tatimin mbi te ardhurat".

Dokumentacioni baze qe m'u paraqit nga drejtimi I shoqerise "Dajko-Koci"Sh.p.k. verteton egzistencen, pronesinë të kapitalit qe zotërohet nga ortakët qe shprehet dhe në zbatimin e procedurave te sakta per pregatitjen e ketij dokumentacioni per zmadhimin e kapitalit.

Të dhëna per Shoqerinë "Dajko-Koci"Sh.p.k. per ortakët dhe kapitalin e saj.

Si shoqëri tregtare në formën e sh.p.k. shoqëria është krijuar me Vendimin nr. 12025, datë 04.09.1995 të gjykatës së rrethit Tiranë me emërtimin "Dajko-Koci" Sh.p.k. e përbërë nga tre ortake. Kapitali themeltar i shoqërise eshte 100.000 lekë, dhe qe zoterohet nga ortakët si:

- 1.Z.Spiro Dajko zoteron 33 % te kapitalit themeltar,
- 2.Z.Sotir Koci zoteron 33 % te kapitalit themeltar,
- 3.Znj.Anthulla Cako zoteron 34 % te kapitalit themeltar.

Me Vendimin nr.2 date 26.10.2004 kërkohet zmadhimi i kapitalit themeltar të shoqërisë "Dajko-Koci"Sh.p.k. Sarande nga fitimet e realizuara dhe rezervat e krijuara deri me 31.12.2003, si rezultat I krijimit te aktiveve te qendrueshme dhe aktiveve qarkulluese te pasqyruara ne aktivin real te shoqerise.

Meqenese shoqeria te gjitha fitimet e realizuara dhe rezervat e krijuara nga ushtrimi I aktivitetit qe nga momenti i krijimit dhe deri me 31.12.2003 I ka riinvestuar ne shoqeri sipas miratimit te llogarive vjetore per cdo ushtrim nga asambleja e ortakeve te shoqerise "Dajko-Koci"Sh.p.k. te cilat nuk I ka depozituar ne gjykate.

Per cdo vit financiar shoqeria hartonte bilanc ku pasqyroheshin gjendjet e te gjitha llogarive e pasurive qe dispononte shoqeria.

Përbërja e zmadhimit të kapitalit të shoqerisë .

1 -Mbështetja ligjore per zmadhimin e kapitalit

- a) Ligji nr.7638 i dates 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare",
- b) Ligji 7661 date 19.01.1993 "Per Kontabilitetin" dhe Plani Kontabel I Pergjithshem I Shqiperise
- c) Statuti I shoqerise "Dajko-Koci" Sh.p.k.



 d) Vendimi nr.2, date 26.10.2004 te Asamblese se ortakeve te shoqerise "Dajko-Koci"Sh.p.k.

e) Vendimi nr. 12025/1 I Gjykates se rrethit Tirane "Miratim eksperti kontabel".

2 - Realizimi i zmadhimit te kapitalit.

Ne perputhje me Vendimin nr.2 date 26.10.2004 te marre nga Asambleja e ortakeve te shoqerise, zmadhimi I kapitalit konsistonte ne kalimin e fitimeve te realizua dhe te rezervave te krijuara te shoqerise deri me 31.12.2003 ne kapitalin e shoqerise.


Per caktimin me saktesi te vleres se zmadhimit te kapitalit qe do te shtohet ne kapitalin themeltar te shoqerise nga fitimet te shoqerise "Dajko-Koci"Sh.p.k. une vertetova:

- a) Saktesine dhe plotesine e dokumentacionit origjinal justifikues te llogaritjeve per fitimet.
- b) Saktesine ligjore te ketij dokumentacioni dhe vertetova se mbartja e tepricave te llogarive te vitit paraardhes ne llogarite e vitit pasardhes eshte bere me saktesi.
- c) Perputhjen e realizimit te zmadhimit te kapitalit te shoqerise sipas kerkesave te e percaktuara ne Vendimin nr.2 date 26.10.2004 te Asamblese se ortakeve.

Puna ime analizuese, kontrolluese dhe vertetimi i kujdesshem i dokumentacionit qe u paraqit nga drejtimi I shoqerise "Dajko-Koci"Sh.p.k Gjirokaster, konkludoj se u perqendrua ne:

- a) Saktesine dhe plotesine e dokumentacionit origjinal justifikues te kryerjes se shpenzimeve ne formen e blerjes dhe krijimit te aktiveve te qendrueshme te trupezuara, te aktiveve qarkulluese, si dhe te drejtave ndaj te treteve te cilat pasqyrohen ne aktivin e shoqerise.
- b) Saktesine ligjore te ketij dokumentacioni. U vertetua se dokumentat kishin te gjitha ekstremet ligjore te duhura ne perputhje me legjislacionin ne fuqi dhe me kerkesat e statutit te shoqerise.
- d) Perputhjen e llojit dhe natyres se shpenzimeve te bera nga financimet e ortakeve per vazhdimesine e veprimtarise te shoqerise.





Ne vijim te kontrollit dhe vertetimit te kujdesshem te dokumentacionit qe u paraqit, dhe nga vërtetimi fizik i bërë pranë qendres se veprimtarise konkludoj qe perberja, vlefte dhe lloji i dokumentave justifikues per secilin lloj te aktiveve reale te shoqerise "Dajko-Koci" sh.p.k. per shtimin e kapitalit te shoqerise nga kontributet e ortakeve me burim fitimet e realizuara dhe rezervat e krijuara nga aktiviteti te krijuara deri më 31.12.2003 te shoqerise "Dajko-Koci" sh.p.k. Sarande paraqitet si me poshte:

Aktivet e qëndrueshme të trupezuara deri me 31.12.2003 janë inventarizuar nga komisioni I ngritur per kete qellim ne fund te vitit 2003 dhe vlefte e tyre eshte gjithsej prej 1.850.000 leke, te pasqyruara ne grupet:

- Toka,troje,terrene,ndertime e inst.te pergjithshme prej 1.550.000 leke,
- Instalime teknike,makineri e paisje prej 300.000 leke.

Aktivet qarkulluese ne fund te vitit 2003 jane ne vlefte prej 14.060.829 leke perbehen si vijon:

- Gjendje te inventarit prej 6.160.000 leke ku jane perfshire vetem gjendja e mallrave sipas inventarit fizik me 31.12.2003,

- Gjendja e kerkesave prej 5.121.732 leke qe perbejne te drejtat e shoqerise ndaj te treteve,

- Gjendja e likuiditeteve prej 2.779.097 leke qe perben gjendjen e parave ne fund te vitit ne arke prej 1.105.250 leke, si dhe gjendja e parave ne llogarine bankare prej 1.673.846 leke.

Nga verifikimi i dokumentacionit baze qe dispononte shoqeria rezulton se aktivet te qendrueshme dhe aktivet qarkulluese jane krijuar nga kontributet e ortakeve formen e financimit te shoqerise prej 8.060.000 leke, si dhe nga fitimet e krijuara deri me 31.12.2003 ne shumen prej 6.315.000 leke e rezervat e krijuara ne shumen prej 340.300 leke.

Fitimet dhe rezervat sipas viteve dhe dokumentacionit.

Sipas dokumentave baze, pre te bilanceve kontabel per cdo vit ushtrimor, pasqyres se humbjeve e fitimeve, rezultojne keta tregues sipas viteve.

Ne vitin 1995 shoqeria ka realizuar nje fitim prej 126.000 leke, ndersa rezerva nuk ka krijuar, pasi llogarite miratohen Brenda 6 mujorit te pare nga data e mbylljes se vitit financiar.





Ne vitin 1996 shoqeria ka realizuar nje fitim prej 476.350 leke, ndersa rezerva nuk ka krijuar.

Ne vitin 1997 shoqeria ka realizuar nje fitim prej 260.000 leke, ndersa rezerva ka krijuar ne shumen prej 56.650 leke.

Ne vitin 1998 shoqeria ka realizuar nje fitim prej 520.000 leke, ndersa rezerva ka krijuar ne shumen prej 40.000 leke.

Ne vitin 1999 shoqeria ka realizuar nje fitim prej 541.350 leke, ndersa rezerva ka krijuar ne shumen prej 41.650 leke.

Ne vitin 2000 shoqeria ka realizuar nje fitim prej 682.500 leke, ndersa rezerva ka krijuar ne shumen prej 52.500 leke.

Ne vitin 2001 shoqeria ka realizuar nje fitim prej 847.000 leke, ndersa rezerva ka krijuar ne shumen prej 60.500 leke.

Ne vitin 2002 shoqeria ka realizuar nje fitim prej 1.236.026 leke, ndersa rezerva ka krijuar ne shumen prej 89.000 leke.


Ne vitin 2003 shoqeria ka realizuar nje fitim prej 1.625.958 leke, ndersa rezerva shoqeria nuk ka krijuar.

Shuma gjithsej e fitimeve te realizuara nga shoqeria gjate ushtrimit te veprimtarise deri me 31.12.2003 eshte prej 6.315.184 leke, ndersa shuma e rezervave te krijuara nga deri me 31.12.2003 eshte prej 340.300 leke.

Gjate verifikimit te dokumentacionit rezultoi se shoqeria ka bere shtesa kapitali per vitin 1995 ne shumen prej 2.200.000 leke, per vitin 1996 ne shumen prej 1.930.000 leke, per vitin 1998 ne shumen prej 1.800.000 leke, per vitin 1999 per shumen prej 3.510.00 leke nga te cilat 1.380.000 leke nga fitimet, ndersa shumen prej 2.130.000 leke nga financimet e ortakeve, dhe per vitin 2000 shtesa e kapitalit eshte ne shumen prej 510.000 leke nga fitimet.

Theksoj se asambleja e ortakeve e shoqerise "Dajko-Koci" Sh.p.k. deri me 31.12.2003 ka vendosur te rrise kapitalin si nga fitimet e shtuara ne llogarine e kapitalit te nenshkruar prej 1.890.000 leke, si dhe nga shuma e fitimeve prej 4.425.000 leke te pasqyruar ne llogarine e fitimeve te ushtrimit 2003 dhe nga rezervat e krijuara deri me 31.12.2003 per shumen prej 340.300 leke. Pra shtesa e





kapitalit gjithsej eshte prej 6.655.000 leke, ndersa diferenca 184 leke do te mbartet pasi nuk ploteson vleren e plote te nje pjese.

Ne shtese te kapitalit do te perfshihet shuma prej 6.655.000 leke, qe ka kunderparti reale (active te qendrueshme e active qarkulluese) ne aktivin e shoqerise "Dajko-Koci"Sh.p.k. sipas dokumentacionit te mesiperm, ndersa diferenca prej 8.060.000 leke perben financimet e bera nga ortaket shoqerise per vazhdimesine e aktivitetit, shuma te cilat duheshin parashikuar ne vendimin e asamblese se ortakeve te shoqerise per te kaluar si shtesa te kapitalit. Mendoj se keto shuma jane object per nje vendim tjeter te asamblese se ortakeve te shoqerise per tu verifikuar dhe hartuar raporti per shtese te kapitalit te shoqerise, pra kjo shume duhet te paraqitet ne bilancin kontabel ne pasiv te bilancit ne grupin e detyrimeve (Ortake), megjithese gjithe dokumentacioni eshte I sakte dhe verteton se treguesit e pasqyruar ne bilancin e ushtrimit 2003 japin nje pamje te sinqerte te pasurise se shoqerise "Dajko-Koci"Sh.p.k.

Vlefte prej 4.765.000 leke do te kaloje ne kredi te llogarise kapitali I nenshkruar, dhe diferenca prej 184 leke (4.765.184 leke – 4.765.000 leke) do te kaloje ne mbartje te fitimeve te viteve te meparshme pasi nuk ploteson vleften e nje pjese te kapitalit.

Ne shumen e kapitalit te nenshkruar eshte perfshire dhe shuma prej 1.890.000 leke per pjesen e fitimeve te kapitalit te shtuar e te pa regjistruar, pra duhet marre si shtese ne kapitalin, perderisa shoqeria e disponon si elemente te kapitaleve te veta, dhe jo si kapital te nenshkruar te regjistruar ne gjykate.

Pra madhesia e shteses se kapitalit te shoqerise bere nga kontributet e ortakut (fitime te realizuara deri me 31.12.2003 dhe rezervat e krijuara) ne kapitalin e shoqerise "Dajko-Koci"Sh.p.k. do te jete shuma totale e fitimeve te realizuara dhe te krijuara prej 6.655.000 leke.

Dokumentacioni original justifikues I kapitalit themeltar ne momentin e krijimit si dhe per shtimin e kapitalit qendron prane shoqerise "Dajko-Koci" Sh.p.k.

Ne perfundim te aktit te ekspertimit te shtimit(zmadhimit) te kapitalit rezultoi se ky shtim (zmadhim) kapitali është bere me perfshirje te fitimeve te realizuara nga shoqeria deri me 31.12.2003 ne shumen prej 6.655.000 leke sipas spjegimeve te mesiperme .

Duke shtuar kapitalin eshte rritur dhe numri I pjeseve, ndersa vlera e nje pjese nuk ka ndryshuar egzistues. Numri I pjeseve eshte rritur prej 6.655 me vlere secila prej 1.000 leke.

Numri I pjeseve te rritura eshte prej 6.655 pjese.



Llogaritja eshte bere sipas formulas:
Shuma e kapitalit themeltar : vleren nominale per nje pjese.

Shtesa e kapitalit themeltar te rritur = 6.655.000 leke.
Vlera nominale e nje pjese = 1.000 leke.

Shtesa e kapitalit prej 6.655.000 leke : 1.000 leke = 6.655 pjese.

Nga analizimi, kontrolli dhe vertetimi I kujdesshem I bere dokumentacionit qe u paraqit, si dhe verifikimit ne vend te kontributeve ne natyre dhe pregatitjes se dokumentacionit sipas kerkesave te Statutit te Shoqerise dhe neneve 61, 63, te Ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare", si dhe Vendimit te nr.2, date 26.10.2004 te asamblese se ortakeve te shoqerise "Dajko-Koci" Sh.p.k. bashkangjitur ketij akti(raporti) konkludoj se vlefte e kapitalit themeltar qe do ti shtohet ne formen e shtimit (zmadhimit) te kapitalit nga fitimet e rezervat eshte prej 6.655.000 leke (gjashtemiljonegjashteqintepesedhjetepesemijeleke).

Kapitali themeltar i nenshkruar i shoqerise se bashku me shtesen e kapitalit nga kontributet (fitime + rezerva) eshte prej 6.755.000 leke (gjashtemiljoneshtateqintepesedhjetepesemije leke), (kapitali themeltar ishte 100.000 leke behet 6.755.000 leke).

Sarande, me 24 Nentor 2004

EKSPERTE KONTABEL E AUTORIZUAR

Leze ABAZI
Eksperte Kontabel e Autorizuar
LEZE ABAZI

